

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 846 Prot.

Tiranë, më 19.06 2017

**VENDIM Nr. 127, datë 05.06.2017**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi Raportin e vlerësimit për devijimet *e gjurmës së Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), Fushata I, II dhe III, për shkak të problemeve gjeologjike* në pikat: KP 116+500-117+600 (RR007 Therepelë), KP 124+700-125+100 (RR-008 Tozhar), KP 143+100 - 143+800 (RR-009 Vodicë), KP 152+180-152+450 (RR-010 Duhanas), KP 161+250-162+800 (RR-012 Veterrik), KP 170+060-177+150 (RR-013 Poshnje), KP 176+060-177+250 (RR-015 Pobrat), KP 195+540-196+520 (RR 016 Vajkan), KP 104+850 - KP 105 +650 (RR-022 Çorovodë) dhe KP 149+250-149+860 (RR-028 Uznovë)- subjekti "SPIECAPAG Shqipëria" paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e vlerësimit për devijimet *e gjurmës së Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), Fushata I, II dhe III, për shkak të problemeve gjeologjike* në pikat: KP 116+500-117+600 (RR007 Therepelë), KP 124+700-125+100 (RR-008 Tozhar), KP 143+100 - 143+800 (RR-009 Vodicë), KP 152+180-152+450 (RR-010 Duhanas), KP 161+250-162+800 (RR-012 Veterrik), KP 170+060-177+150 (RR-013 Poshnje), KP 176+060-177+250 (RR-015 Pobrat), KP 195+540-196+520 (RR 016 Vajkan), KP 104+850 - KP 105 +650 (RR-022 Çorovodë) dhe KP 149+250-149+860 (RR-028 Uznovë)-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Në zonën KP 124+700-125+100 (RR-008 Tozhar) dhe KP 149+250-149+860 (RR-028 Uznovë), ku ka patur gjetje të shumta qeramike, të depozitohet pranë ASHA, sipas metodologjisë paraardhëse, koncepti i kryerjes së sondazheve arkeologjike, sipas të cilit do të kryhen sondazhet, në vijim të akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur më parë ndërmjet subjektit "SPIECAPAG Shqipëria", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA që do të mbikëqyrë atë.
3. Në zonën KP 161+250-162+800 (RR-012 Veterrik) të kryhet dokumentimi i rrënojave të fshatit të braktisur Veterrik.

4. Në zonat e tjera, të vijojnë punimet e ndërtimit, sipas devijimeve të gjurmës së Linjës së Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), Fushata I, II dhe III, të përcaktuar në Raportin e vlerësimit të sipërpërmendur.
5. Të kryhet nga shoqëria e licencuar në arkeologji, ndjekja në mënyrë periodike ditore e punimeve të gërmimit, për ndërtimin "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP)" :
  - Fushata e I ((KM 211.8 - KM 145) sipas akt- marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 76, datë 15.07.2016
  - Fushata e II (KM 0-69) sipas akt- marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 99, datë 14.09.2016
  - Fushata e III (KM 69 - KM 139.674) sipas akt- marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet ndërmjet "SPIECAPAG Shqipëria", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, përcaktuar në pikën 3 të vendimit të KKA Nr. 40, datë 24.03.2017
6. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjeve tre palëshe.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
8. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**